

**VENDIM**  
**Nr. 377, datë 21.6.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 228, DATË 13.4.2023,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E  
VITIT 2023, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR FINANCIMIN E  
FESTIVALIT FOLKLORIK KOMBËTAR GJIROKASTËR, 24 QERSHOR–2 KORRIK  
2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë , Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 1, të vendimit nr. 228, datë 13.4.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Në shpenzimet kapitale “Investime” shtohet fondi prej 830 000 (tetëqind e tridhjetë mijë) lekësh për blerje pajisjesh për zonën e spektatorëve dhe ambiente të tjera në kala.”.

Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Në shpenzimet “Operative” shtohet fondi prej 11 900 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh për grantet e qarqeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**